



“PUNIME MBROJTJE NGA PERROI GRYKE MANATI”

BASHKIA LEZHE

PROJEKT ZBATIMI

RELACIONI TEKNIK

SHTATOR 2023

RAPORT TEKNIK

OBJEKTI: “PUNIME MBROJTJE NGA PERROI GRYKE MANATI” BASHKIA LEZHE

I.- HYRJA

Projekt Zbatimi i objektit :”**Punime mbrojtje nga Perroi Gryke Manati**” eshte pergatitur ne baze te Detyres se projektimit te Bashkise Lezhe .

Me sqarimin e detyres projektimit te marre nga Bashkia Lezhe, ne planimetrine ne shk 1:25 000, u fiksua zona ku do te operohet per realizimin e kerkesave te detyres se projektimit per objektin :”**Punime mbrojtje nga Perroi Gryke Manati**”

Rrethi i Lezhes ka 17 perrenj malore qe percjellin ujrat e zones kodrinore malore per ne lumin Drin.Nje nga perrenjte me problematike dhe per nga prurja e ujit me i madhi eshte Perroi i Grykes.Ky perrua prej vitesh ka sjelle probleme per sa i perket permbytjeve.

Perroi Gryke Manati eshte nder perrente kryesore ne Bashkine e Lezhes.Fillon ne kreshtat e maleve qe ndajne Gryke Manatine me fshatin Vele dhe derdhet ne Lumin Drin te Lezhes pothuajse ne qender te qytetit.

Pjesa fundore e ketij Perroi nga nderprerja me rrugen e vjeter nacionale Milot -Lezhe deri ne derdhje ne lume me gjatesi rreth 2.1 km eshte ne administrim te Drejtorise se Ujitjes dhe Kullimit Lezhe.Ndersa pjesa tjeter nga Prita Malore ne afersi te kesaj rruge dhe deri ne krijimin e tij eshte ne administrim te Bashkise Lezhe.Pelgu shimbledhes i ketij perroi eshte afro 2 085ha. Nder vite eshte nderhyre me investime te pjeseshme per mbrojtje nga ky perrua pasi eshte mjaft problematik per aresye te prurjeve te shumta te ujit dhe atyre te ngurta duke rrezikuar ne mjaft raste komunitetin qe banon ne keto zone dhe tokat bujqesore ne administrim te tyre.

Permbytjet e vitit 2010 u bene shkak per ndertimin e nje tjeter prite malore ne fshatin Patalej mbi shkollen e ketij fshati.

Rreth 250 ml mbi kete aks kemi bashkimin e Perroit te Ullirit,Perroit te Kaçinarit,Perroit te Grykave,Perroin e Arres se Ndreut dhe Perroin e Qafes se Bunges.

Duke filluar nga kjo prite e deri te prita e poshteme eshte e domosdoshme nderhyrja per mbrojtje nga ky perrua.

Nderhyrja eshte emergjente ne pese segmente,konkretisht:

- 1- Mbrojtje nga Perroi Gryke Manati**
- 2- Rehabilitimi i prites malore ne Gryke Manati**

Detyra e projektimit kerkon rehabilitimin e ketij segmenti

II.- TE DHENA TE DETYRES SE PROJEKTIMIT

Projekt Zbatimi është hartuar ne baze te detyres se projektimit, hartuar nga Bashkia Lezhe. Detyra e projektimit kerkon rehabilitimin e Perroi Gryke Manati ne segmentin mbi priten dhe nen priten.

Ne projekt te parashikohen te gjitha punimet, qe kane te bejne me mbrojtjen e nga Perroi Gryke Manati ne kete segment sipas Kushteve Teknike te Projektit.

Projekti i zbatimit duhet te paraqese:

- ⇒ Planimetrine, profil gjatesor dhe profila terthore.
- ⇒ Relacionin teknik
- ⇒ Preventivin e punimeve
- ⇒ Specifikimet teknike

Cmimet e vleresimit do ti referohen manualit MRTT.

III.- RELACIONI TOPOGRAFIK

Nga rikonicioni i kryer ne vend dhe konsultimi me specialistet e Bashkise Lezhe verejme se Perroi Gryke Manati duhet te pastrohet ne segmentin fundor te tij paralel me priten malore gryke Manati.

Pikat dhe koordinatat konkrete ku ne kemi vendosur bazën e GPS-it tonë janë te dhena ne planimetrite perkatese.

Saktësia e realizuar në matje me GPS-in tonë është +- 1 cm në plan dhe +- 1.5 cm në kuotat për një rreth me rreze 5 000 metra (ose diametër 10 000 metra). Kjo saktësi është maksimalisht e mjaftueshme për kërkesat teknike të projektit.

Në të gjithë zonen e rilevuar ne kemi vendosur disa pika të forta me gozhde betoni dhe kunjat hekuri të cilat do të shërbejnë gjatë zbatimit të projektit (pikat poligonale).

Këto pika poligonale u shfrytëzuan njëkohësisht për gjithë rilevimin e zones.

Koordinatat planimetrike dhe altimetrike të këtyre pikave janë të paraqitura në fletet përkatëse, si dhe ne nje tabele te permbledhur.

Vendi ku do te ndertohet objekti eshte ne pronesi te Bashkise Lezhe.

Rilevimi eshte realizuar ne kete menyre:

Si fillim qe ne momentin e pare eshte bere rikonicioni i zones dhe eshte vendosur per menyren e kryerjes se ketij procesi. Duke menduar qe te dhenat topografike do te jene sipas rrjetit koordinativ shteteror eshte filluar me grumbullimin e materialeve te nevojshme per transformimin e te dhenave tona ne kete rrjet. Keshtu nga hartat 1:25 000 te zones jane identifikuar pikat e triangolacionit Shqiptar dhe jane marre te dhenat nga Instituti Topografik Usharak per keto pika si dhe listen e reperave dhe te markave ne kete zone. Me pas eshte zhvilluar nje rrjet poligonal i mbeshtetur ne keto pika dhe duke perdorur teknologjine GPS. Me nje GPS baze dhe tre recivitor GPS eshte ndertuar nje rrjet trekendeshash per te llogaritur koordinatat e pikave te poligonit ne menyren me te sakte te mundur. Llogaritja e pikave poligonale te matura me GPS per çdo pike eshte skicuar nje vizatim per te treguar vendndodhjen e pikes ne lidhje me objekte fikse dhe e shoqeruar me fotografi dixhitale, kjo do te perbej monografine e pikave poligonale.

Gjithashtu jane fiksuar ne terren pikat fikse te fillimit dhe te mbarimit te rrugeve si dhe pika te tjera te rendesishme qe jane gjykuar te domosdoshme.

Te gjitha pikat e rilevuara ne terren jane te regjistruara me kode speciale ne memoriet e brendshme te instrumentave te perdorura nga ana jone. Pikat e regjistruara ne terren jane transferuar ne kompjuter me programet e realizuara perkatesisht per kete proces. Me vone te

gjitha pikat jane perpunuar dhe u be krijimi i hartes dixhitale ne shkalle reale ne kompjuter. Ne terren jane rilevuar te gjitha pikat karakteristike per te pozicionuar te gjitha detajet. Rendesit e veçante i eshte kushtuar pozicionimit te detajeve si: ndertimet e ndryshme civile, elementet e infrastruktures, (rrjeti elektrik, telefoni, ujesjelles) etj. Programi qe eshte perdorur ka te vizatuar te gjitha elementet planimetrik. Te dhenat finale jane “file” dwg si dhe nje Model i Terrenit ne forme dixhitale ne formatin DXF per projektimin e rrugeve me programet perkatese. Te dhenat dixhitale permbajne te gjitha linjat e nderprerjes se terrenit per nje ndertim shume te mire te modelit tridimensional. Te gjitha detajet topografike jane te pranishme. Ndermjet te tjerave jane: rruge te asfaltuara dhe te pa asfaltuara, shtepi dhe mure mbajtes, peme, puseta egzistuese dhe te gjitha sherbimet e ndryshme urbane, kanale dhe rrethime siperfaqesh etj. Te gjitha pikat e matura jane te pranishme ne harten e krijuar. Izoipset jane krijuar nepermjet programit perkatese.

IV.- RELACIONI HIDRAULIK

Perpunimi i te dhenave **per prurjet (rrjedhjet) maksimale** eshte trajtuar duke u bazuar kryesisht ne te dhenat e mesiperme e duke bere perpunimet e nevojshme sipas disa prej programeve me te perdorshme e qe jane vertetuar edhe ne mjaft raste te ngjashme:

Kryesisht jane shfrytezuar e jane perdorur teori si me poshte :

- Ne te dhenat dhe perpunimet e trajtuara ne disa raste nga libri **“Hidrologjia e Shqiperise”** , botim i Institutit Hidrometeorologjik te Akademise se Shkencave te Republikes se Shqiperise;
- Ne te dhenat dhe perpunimet e trajtuara ne disa raste nga libri **“Veçoritë Klimaterike dhe Hidrologjia e Ultesires Bregdetare** te Shqiperise, botim i Institutit Hidrometeorologjik te Akademise se Shkencave, te Republikes se Shqiperise; si dhe ,
- Eshhte shfrytezuar e perdorur teoria e programuar dhe e pershkruar ne broshuren **“ Manual i rreshjeve dhe prurjeve llogaritese ne Shqiperi”** , vitit 2001. (Broshure udhezuese,) hartuar nga **Kompania Angleze “HALCROW” Londer; (Shih).**

Pervec perpunimit te rreshjeve maksimale ne kohë e ne perseritje (probabilitete) te ndryshme, ne mungese te stacionit Hidrometeorologjik ne Manati, studimi eshte mbeshtetur dhe ka bere krahasimet e nevojshme edhe ne te dhenat e stacionit Hidrometeorologjik te Lezhes ku jane regjistruar te dhena te vlefshme per sasite e rreshjeve maksimale ne intervale kohore te ndryshme por edhe me probabilitete te ndryshme te perseritjes se ketyre rreshjeve.

Konkretisht :

-Llogaritje paraprake ne pellgje ku mungojne te dhenat :

Nepermjet Metodes Racionale e cila ka per formule baze :

$$Q_p = 16.7 \times i_{tc,p} \times a \times \delta_1 \times A$$

ku :

16.7 – koeficient konstant qe rregullon njesite ne ekuacion

A – siperfaqja e pellgut ujembledhes e shprehur ne km^2 (**A= 20.85 km^2**)

a – koeficienti i rrjedhjes (**a= 0.5**)

δ_1 – koeficienti i ndikimit te liqeneve dhe kenetave (**$\delta_1=1$**)

$i_{t_c,p}$ – intensiteti i shiut per nje kohezgjatje t_c dhe nje probabilitet tejkalimi p e shprehur ne (mm/minute).

Gjejme kohen e bashkeardhjes nepermjet formules 8.41 :

$$t_c = 4 \times \left(\frac{L}{\sqrt{S}} \right)^{0.77} = 4 \times \left(\frac{3.19}{\sqrt{0.0135}} \right)^{0.77} = 4 \times \left(\frac{3.19}{0.116} \right)^{0.77} = 51.32 \text{ minuta} = 0.85$$

ore

ku :

t_c – koha e bashkeardhjes e shprehur ne minuta

L – gjatesia totale e lumit e shprehur ne km ($L=3.19$ km)

S – pjerresia mesatare e lumit ($S=0.0135$)

Per llogaritjen e shirave me kohezgjatje dhe siguri te ndryshme ne vendmatje pa pluviograf perdoret formula (8.45)

$$h_{p,t} = H_{p,24} \times \left(\frac{t_c}{24} \right)^n$$

ku :

$H_{p,24}$ – lartesia e shiut maksimal 24 oresh me siguri p

t_c – kohezgjatja e shiut e shprehur ne ore

n – parameter i reduktimit, vlere e te cilit ne kushtet e vendit tone ndryshon nga **0.25-0.5** ne varesi te vendmatjes.

Tab. 8.4 Vlerat e $H_{p,24}$ dhe n për disa vendmatje meteorologjike kryesore të Shqipërisë (marrë nga lit. 13.)

Nr	Vendmatja	Siguria (%)							
		1		2		5		10	
		$H_{p,24}$	n	$H_{p,24}$	n	$H_{p,24}$	n	$H_{p,24}$	n
1	Arrez c Vogel	175	0.332	156	0.334	131	0.336	111	0.339
2	Belsh	156	0.303	141	0.305	122	0.306	106	0.310
3	Bilisht	78	0.363	71	0.363	62	0.362	55	0.361
4	Bogë	258	0.379	230	0.379	211	0.379	191	0.379
5	Cerkovice	145	0.355	133	0.354	118	0.351	107	0.347
6	Dajt fshat	230	0.340	207	0.343	177	0.347	153	0.352
7	Domgjon	213	0.375	196	0.373	173	0.368	155	0.364
8	Dragobi	252	0.310	229	0.312	200	0.314	177	0.316
9	Dushar	190	0.327	171	0.328	145	0.332	125	0.336
10	Erind	272	0.407	244	0.412	207	0.420	178	0.428
11	Fierze	284	0.319	255	0.322	217	0.328	187	0.335
12	Goranxi	319	0.395	287	0.400	244	0.409	211	0.419
13	Gramsh	117	0.406	107	0.405	93	0.405	82	0.406
14	Kardhiq	360	0.436	324	0.439	276	0.446	239	0.452
15	Kavaje	211	0.260	188	0.262	157	0.265	133	0.269
16	Koplik	202	0.318	184	0.319	161	0.319	142	0.320
17	Kruje	199	0.372	180	0.373	155	0.373	135	0.375
18	Leskovik	109	0.372	100	0.371	89	0.368	81	0.363
19	Lezhe	206	0.297	188	0.298	162	0.302	142	0.306
20	Ligenas	139	0.276	125	0.279	106	0.285	91	0.292
21	Longo	341	0.411	306	0.416	260	0.413	224	0.431
22	Milot	189	0.343	171	0.344	146	0.345	127	0.347
23	Miras	90	0.347	82	0.349	72	0.350	64	0.352
24	Nivice	284	0.473	257	0.477	221	0.482	193	0.488
25	Ndroq	226	0.264	230	0.266	172	0.271	148	0.275
26	Permet	174	0.458	160	0.457	142	0.454	127	0.453
27	Potom	121	0.374	110	0.376	95	0.379	83	0.383
28	Qërec Mulaj	283	0.350	257	0.351	222	0.353	195	0.355
29	Radomirë	128	0.374	118	0.373	104	0.374	93	0.375
30	Selenice	142	0.274	127	0.278	108	0.282	93	0.287
31	Simon	212	0.338	192	0.339	165	0.343	144	0.347
32	Tepelenc	155	0.499	143	0.497	125	0.495	112	0.492
33	Theth	387	0.312	352	0.311	306	0.310	270	0.308
34	Vau Dejës	212	0.354	192	0.355	166	0.354	146	0.354
35	Zvërinë	92	0.324	83	0.328	72	0.332	63	0.337

Tabela 8.4 (Hidrologjia Inxhinierike- A.Selenica)

Nisur nga tabela e mesiperme reshjet maksimale 24 oreshe me siguri 1 % jane $H_{1\%,24} = 206 \text{ mm}$, ndersa faktori i reduktimit $n=0.297$.

Duke iu rikthyer formule 8.45 :

$$H_{1\%,24} = H_{1\%,24} \times \left(\frac{tc}{24}\right)^n = 206 \text{ mm} \times \left(\frac{0.85}{24}\right)^{0.297} = 76.38 \text{ mm}$$

$$i_{tc,p} = \left(\frac{H_{1\%,24}}{tc(\text{minuta})}\right) = \left(\frac{76.38 \text{ mm}}{51.32 \text{ minuta}}\right) = 1.48 \text{ mm/minute}$$

Duke iu rikthyer zevendesimeve tek formula baze e Metodes Racionale kemi :

$$Q_{1\%} = 16.7 \times i_{tc,p} \times a \times \delta_1 \times A = 16.7 \times 1.48 \times 0.5 \times 1 \times 20.85 = 257.66 \text{ m}^3/\text{s}$$

Nje tjeter menyre e marre ne konsiderate eshte nepermjet llogaritjes se parametrave te lakores se sigurise binominale e cila mund te llogaritet ne menyren analitike dhe ate grafoanalitike.

Duke qene se kemi te dhena te 10 viteve te njepasnjeshme te marra nga website : www.tcktcktck.org per sasine e reshjeve atehere do te perdoren per llogaritjet e meposhtme :

Reshjet Max 24 h										Ordinatat e Kurbes se Sigurise per Cs=4 x Cv	
Nr	Viti	Reshjet	Viti i Renditur	Reshjet 24 h te renditura	P % = m/(n+1)	K	K-1	(K-1)x(K-1)	P	Kp	Hm
1	2010	60.7	2019	192	8.33	2.99617	1.99617	3.984693349	0.01	6.726	431.01
2	2011	28.2	2020	72.4	16.67	1.12981	0.12981	0.016849506	0.03	5.757	368.92
3	2012	48.7	2017	69.6	25	1.08611	0.08611	0.007415191	0.05	5.358	343.35
4	2013	54.7	2010	60.7	33.33	0.94723	-0.0528	0.002785036	0.1	4.788	306.82
5	2014	45.9	2013	54.7	41.67	0.8536	-0.1464	0.021434057	0.5	3.568	228.66
6	2015	50.7	2015	50.7	50	0.79118	-0.2088	0.043607441	1	3.158	202.36
7	2016	49.2	2016	49.2	58.33	0.76777	-0.2322	0.05393148	2	2.713	173.87
8	2017	69.6	2012	48.7	66.67	0.75997	-0.24	0.057616344	3	2.485	159.26
9	2018	32.8	2014	45.9	75	0.71627	-0.2837	0.080501685	5	2.200	140.99
10	2019	192	2018	32.8	83.33	0.51185	-0.4882	0.238294668	10	1.835	117.62
11	2020	72.4	2011	28.2	91.67	0.44006	-0.5599	0.313530093	20	1.493	95.70
				704.9				4.82065885	25	1.379	88.39
									30	1.288	82.55
									40	1.129	72.32
									50	1.015	65.02
									60	0.901	57.71
									70	0.809	51.87
									75	0.752	48.22
									80	0.695	44.56
									90	0.593	37.99
									95	0.502	32.14
									97	0.456	29.22
									99	0.388	24.84
									99.9	0.285	18.26

$$H_{mes} = \sum H_{24h} / n = 704.9 / 11 = 64.08$$

Percaktojme koeficientin e variacionit Cv :

$$C_v = \sqrt{\frac{\sum (k-1)^2}{n-1}} = \sqrt{\frac{4.82}{10}} = 0.69$$

Koficijenti i asimetrise per reshjet max. 24 h eshte :

$$C_s = (4 \times C_v) = 4 \times 0.69 = 2.77$$

$$H_p = (K_p \times H_{mes}) = K_p \times 64.08$$

Perpunimi i rreshjeve maksimale 24 oreshe sipas te dhenave te Stacionit Pluviometrik Shkoder eshte bere duke i larguar nga mesatarja e ordinatave te kurbes se sigurise Pirsonit per Cs=4Cv per vlerat e llogaritura te koeficientit te asimetrise Cs

Llogaritja e prurjes

Treguesit e Pellgut shimbledhes

Siperfaqja e pellgut shimbledhes eshte F = 2085 ha.

Gjatesia e perroit mesatarisht 3.19 km.

Pjerrësia mesatare e perroit deri ne aks eshte i= 0.0135.

Gjeresia mesatare e shtratit 8 m.

Per nga rendesia e vepres, nisur nga normativat e projektimit do te punojme me prurjen llogaritese me 3 % siguri dhe prurjen kontrullouese me 1% siguri.

1- Shpejtësia e rrjedhjes së rrymës së ujit

Sipas formulës së Sokolovskit është $V_{\max} = 17 I^{0.4} \times b_m^{0.5}$, ku :

I - është pjerresia e shtratit 0.0135

b_m - gjersia mesatare në seksionin llogaritet në nivelin maksimal të ujit në metra

Nga perlllogaritjet rezulton $V_{\max} = 8.59$ m/sek.

Pra kemi $V_{\text{mes}} = 0.1 \times V_{\max} = 8.59 / 10 = 0.86$ m/sek.

2-Llogaritja e kohës së bashkeardhjes

t - koha e bashkeardhjes = $L / 3.6 V = 0.76$ ore ,
ku L është gjatësia e matur e lumit $L=3.19$ km

3-Llogaritja e kohës të ngadalsimit të shiut

$T = \mu \times t$, ku:

μ - është koeficienti i ngadalsimit të shiut dhe llogaritet me formulën :

$$\mu = (t+1)^{-0.20} = 0.893$$

Duke zëvendësuar llogarisim $T = 0.68$ ore.

4- Kohezgjatja e shiut

Sipas Venturit jepet me formulën :

$$r = 0.1272 \sqrt{F/I} = 0.1272 \times \sqrt{20.85/0.00135} = 4.99 \text{ ore.}$$

5- Llogaritja e koeficientit të rrjedhjes

Sipas Korbejt llogaritet me formulën empirike $\alpha = a + b/\sqrt{r}$

Ku a dhe b janë koeficiente empirike; $a = 0.20$ dhe $b = 0.40$; $r = 4.99$

Duke zëvendësuar në formulë përcaktojmë $\alpha = 0.2 + 0.4/\sqrt{4.99} = 0.37$

6- Llogaritja e prurjes orare

$$Q_{\text{orare}} = H_{24 \text{ ore}}^{1\%} / \sqrt{24} = 202.36/4.9 = 41.29 \text{ mm/ore.}$$

$$Q_{\text{orare}} = H_{24 \text{ ore}}^{3\%} / \sqrt{24} = 159.26/4.9 = 32.50 \text{ mm/ore.}$$

7- Llogaritja e reshjeve

Reshjet me 1 % dhe 3 % siguri të përpunuara jepen me formulën :

$$H_t = Q_{\text{orare}} \times T^{1/3}$$

$$H_t = Q_{1\% \text{ orare}} \times T^{1/3} = 41.29 \times 0.68^{1/3} = 36.29 \text{ mm/ore}$$

$$H_t = Q_{3\% \text{ orare}} \times T^{1/3} = 32.50 \times 0.68^{1/3} = 28.56 \text{ mm/ore}$$

Prurja llogaritet :

$$\text{Sipas formules se Sokolovskit } Q = \frac{0.28 \times \alpha \times H_t \times F}{t}$$

α - eshte koeficienti i rrjedhjes qe per pellgun tone shimbledhes rezultoi 0.37.

F - eshte siperfaqja e pellgut shimbledhes qe per aksin tone eshte 20.85 km².

H_t - sasia orare e reshjeve per 1 % siguri eshte llogaritur 36.29 mm/ore.

H_t - sasia orare e reshjeve per 3 % siguri eshte llogaritur 28.56 mm/ore.

t - koha e bashkeardhjes - 0.76 ore

Duke zevendesuar ne formulen e Sokolovskit marrim prurjen llogaritese

$$Q_{1\%} = 105.48 \text{ m}^3/\text{sek}$$

$$Q_{3\%} = 83.02 \text{ m}^3/\text{sek}$$

Duke gene se te dhenat e viteve te fundit jane me te pranueshme atehere do te pranojme prurjen qe llogaritem me metoden e Sokolovskit pra

$$Q_{1\%} = 105.48 \text{ m}^3/\text{sek}.$$

V.- ZGJIDHJA TEKNIKE E PROJEKTIT

Pas rikonicionit ne vend, grupi i projektimit konstatoi se punimet qe kerkohen ne detyren e projektimit jane te domosdoshme sepse verehen mbushje nga materialet e sjella nga perroi ne segmentin mbi priten Gryke Manati dhe gjithashtu dhe ne pusin e shuarjes ne segmentin deri te ura e rruges nacionale. Po ashtu segmenti mbi prite ka dhe shume bimesi te larte te zhvilluar.

Objekti ndahet ne dy nenobjekte :

1.Punime dheu per perroin Gryke Manati

Projekti ka parashikuar prerjen e bimesise ne segmentin paralel me argjinaturen. Eshte parashikuar pastrimi i perroit ne kete segment duke krijuar nje kanal me baze te poshteme 24 m. Pas pastrimit te argjinatures nga bimesia do te shihet gjendja e skarpates nga ana e brendeshme nese ka nevojte per ndonje nderhyrje. Dherat e dala nga germimi do te sistemohen ne te dy anet e perroit.

2.Punime per riparimin e prites malore Gryke Manati

Projekti ka parashikuar prerjen e bimesise ne segmentin poshte prites ne pusin e shuarjes deri te ura ne rrugen nacionale. Eshte parashikuar pastrimi i perroit ne kete segment.

Pas pastrimit te pusit te shuarjes nga bimesia do te shihet gjendja e veshjes egzistuese dhe do te behet riparimi i nevojshem. Eshte parashikuar nderhyrje ne anen veriore per te bere permiresimin e skarpates se pusit te shuarjes. Dherat e dala nga germimi do te sistemohen ne kete ane te perroit.

Projekti ka parashikuar riparimin e pragut kaperderdhes te prites duke bere me pare prishjen e brezit te betonit egzistues sepse eshte pothuajse i demtuar. Eshte parashikuar ndertimi i nje ekрани betonarme me trashesi 20 cm nga ana e brendeshme e prites qe do vazhdoje dhe ne kuroren e pragut kaperderdhes ne forme kapuçi. Kjo nderhyrje do te behet ne te gjithë frontin kaperderdhes te prites.

“ANGERBA”sh.p.k.

Eshte parashikuar gjithashtu ndertimi i fugave me llaç çimernto ne anen e poshteme te prites ne murin vertikal.

Grupi i projektimit eshte i gatshem te bashkepunoje per ndonje ndryshim te mundeshem qe kushtezohet nga koha e zbatimit te ketij projekti

VI.- AFATI I KRYERJES SE PUNIMEVE

Projekti parashikon qe per kryerjen e punimeve per objektin **”Punime mbrojtje ne Peroin**

Gryke Manati” nevojitet nje afat prej 1 muaj. Menyra e kryerjes se punimeve jepet ne grafikun bashkelidhur raportit teknik.

VI.- ORGANIZIMI I PUNIMEVE

Për ndërtimin e objektit: **”Punime mbrojtje ne Peroin Gryke Manati”**, projekti parashikon të përdoren materiale të cilësisë së lartë sipas standarteve të vendit dhe ndërkombëtare dhe të zbatohen me rigorozitet Kushtet Teknike të Zbatimit të punimeve.

Materialet e objektit do te merren ne prodhuesit qe plotesojne kerkesat e specifikimeve teknike.

VII.- PREVENTIVI

Preventivi eshte hartuar ne baze te VKM 629, dt.15.07.2015, dhe vlere e plote me 5 % fond rezerve eshte **6 700 009** leke me TVSH.

“ANGERBA ”shpk

Ing. Burhan HAFIZI

